



Pranimi / Dorezimi Pratje / Prilazje Received / Delivety	07-04-2022	2	viti god year
Organ / Alesia Organ / Jedinstvo Org / Unit	Dr. Prof. Dr. Prof. Prof. No.	Shtopa / Piteq Appendix	Sasia Kelsina Quantity
SKPMSTHKK	1948/2022		1/3



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOS

A.nr.171/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca –kryetar , Malsore Gashi Bajraktari dhe Arben Mehmeti -anëtarë, si dhe Sabile Avdyli- Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.171/2022 të datës 25.02.2022 të parashtruar nga ankuesit _____ dhe _____ të cilët i përfaqëson me autorizim _____ me adresë _____ kundër organit të punësimit Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, në çështjen juridike “Kompensim Material”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 07.04.2022, njëzëri mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.171/2022 e datës 25.02.2022 e parashtruar nga grup ankuesish _____ dhe _____

A r s y e t i m

Ankuesit, _____ dhe _____ nëpunës civilë në Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës, më datë 25.02.2022 përmes përfaqësuesit të autorizuar kanë parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Ministrisë së Financave Punës dhe Transfereve për mos zbatimin e Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës, lidhur me kompensimin e shujtës ditore dhe pagës jubilarë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 03.03.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesve të organi i punësimit, ndërsa ky i fundit më datë 25.03.2022, ka dërguar përgjigje në ankesë së bashku me shkresat e lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën e datës 25.02.2022 me numër të protokollit 1002/2022 të parashtruar nga ankuesit në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Dëftesë për pranimin e dërgesës e datës 10.02.2022; Kërkesë për kompensimin e pagës jubilarë dhe shujtave ditore e datës 09.02.2022; Kërkesë për kompensimin e pagës jubilarë dhe shujtave ditore e datës 16.02.2022 me nr.150; Njoftimi i datës 22.12.2022;

Autorizim i datës 14.07.2021 për
Autorizim i datës 14.07.2021 për
protokolli 1603/2022 bashkë me shkresat e lëndës faqe 1/16; E-mail zyrtar i datës 24.03.2022; Akt
emërimi i datës 06.09.2019 për
emërimi i datës 28.12.2017 për
muajit Shtator 2017; Dëshmi për realizimin e pagës jubilarë për
dhe Dëshmi për realizimin e pagës jubilarë për

Autorizim i datës 14.07.2021 për
Përgjigje në ankesë i datës 25.03.2022 me numër
Akt emërimi i datës 28.12.2017 për
Dëshmi për realizimin e pagës jubilarë për
e muajit Shkurt 2022;
e muajit Dhjetor 2020.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit dhe analizimit të të gjitha provave të parashtruar nga palët konstatoi së ankesa e ankuesve është *e pa bazuar, sepse:*

Kolegji bazuar në shkresat e lëndës ka gjetur se ankuesi sipas Akt emërimit me numër protokoll 284 të datës 06.09.2019 është i punësuar në pozitën e punës *Udhëheqës i Zyrës së Punësimit* në Mitrovicën e Veriut, ankuesi sipas Akt emërimit me numër protokoll 138 të datës 28.12.2017 është i punësuar në pozitën e punës *Zyrtar për Administrimin e Teknologjisë Informativë* në Mitrovicë, ndërsa ankuesja sipas Akt emërimit me numër protokoll 137 të datës 28.12.2017 është e punësuar në pozitën e punës *Zyrtare për Shërbime të Punësimit* në Zyrën e Punësimit në Mitrovicë, që të gjithë në kuadër të Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës.

Përfaqësuesi i autorizuar i ankuesve, më datë 16.02.2022 i është drejtuar me kërkesë Ministrisë së Financave Punës dhe Transfereve, për kompensimin e pagës jubilarë dhe shujtës ditore për ankuesit për periudhën kohore nga data 09.02.2016 deri me datë 09.02.2022 mbi bazën juridike/Marrëveshjen e Përgjithshme Kolektive të Kosovës. Sipas përgjigjes në ankesë të organit të punësimit, ankuesit me datë 22.02.2022 janë njoftuar lidhur me refuzimin e kërkesës të datës 16.02.2022.

Kundër njoftimit të datës 22.02.2022 lidhur me refuzimin e kërkesës nga organi i punësimit, ankuesit më datë 25.02.2022 përmes përfaqësuesit të autorizuar kanë parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve për mos zbatimin e Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive. Të njëjtit pretendojnë se Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve duhet t'i zbatoj dispozitat e Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës, përkatësisht neni 52, 53 dhe 54 të kësaj marrëveshje ku parashihet kompensimi i shujtave ditore dhe pagave jubilarë, dhe mbi këtë bazë juridike kërkojnë kompensimin e shujtës ditore dhe pagës jubilarë për periudhën kohore nga data 09.02.2016 deri me 09.02.2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore analizoi bazën ligjore mbi të cilën janë ngritur pretendimet ankimore të ankuesve dhe si rrjedhojë konstatoi se Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës (MPKK) e publikuar në Gazetën Zyrtare Nr.38/2014 të datës 18.06.2014 ka hyrë në fuqi më datë 01.01.2015 dhe e njëjta sipas nenit 90 paragrafi 4 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, ka qenë e zbatueshme në periudhë jo me shumë se tri (3) vjet, respektivisht deri me datë 31.12.2017. Kolegji po ashtu ka konstatuar se Oda Ekonomike e Kosovës si Partner i barabartë në Këshillin Ekonomiko Social, dhe njëherit nënshkruese e MPKK-së, me datë 15.09.2017 është tërhequr nga zbatimi i MPKK-së, dhe rrjedhimisht ka pamundësuar zbatimin e Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive pas datës 31.12.2017. Andaj pretendimi ankimor i ankuesve mbi këtë bazë juridike është i pabazuar ngase Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës nuk është në fuqi në kohën kur ankuesit kanë parashtruar pretendimet ankimore, dhe rrjedhimisht edhe drejta e kompensimit të shujtave ditore



dhe pagave jubilarë në mënyrë retroaktive mbi këtë bazë juridike është parashkruar në kuptim të nenit 87 të Ligjit Nr.03/L-112 të Punës, ku përcaktohet se: *Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës.*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të shkresave të lëndës ka konstatuar se ankuesit _____ në emër të shpërblimit jubilar i janë kompensuar 93.50 euro me listën e pagave të muajit Shtator 2017, ankuesit _____ në emër të shpërblimit jubilar i janë kompensuar 97.24 euro me listën e pagave të muajit Shkurt 2022, ndërsa ankueses _____ në emër të shpërblimit jubilar i janë kompensuar 97.24 euro me listën e pagave të muajit Dhjetor 2020. Rrjedhimisht Kolegji konstaton se organi i punësimit me rastin e kompensimit të shpërblimit jubilar ka vepruar në pajtim me dispozitat e Ligji Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë, përkatësisht nenin 22 paragrafi 2 ku përcaktohet se: *2. Nëpunësit civilë, kanë të drejtat në vijim: 2.3 shpërblimi i përvjetorit (jubile), si dhe nenin 21 të Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civilë ku përcaktohet se: Sipas nenit 22 të Ligjit për Pagat e Nëpunësve Civilë, nëpunësve civilë, të cilët janë në marrëdhënie të vazhdueshme pune në Shërbimin Civil iu takon një shpërblim në vlerë prej 25% të pagës mesatare në Shërbimin Civil pas çdo dhjetë (10) vjetësh pune.*

Kështu që pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe neni 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda: A.nr.171/2022, datë 07.04.2022

Sabile AVDYLI

Sabile Avdyli
Procesmbajtëse



Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit të autorizuar të ankueseve,
- Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Financave Punës dhe Transfereve;
- Udhëheqësit të Personelit në Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së